



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 75/16
Prishtinë, më 22.12.2016, ora 19:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Sali Morina, Bali Muharremaj, Shqipe Pantina dhe Fikrim Damka.

Munguan: Enver Hoti dhe Jelena Bontić.

Në mbledhje po ashtu morën pjesë, deputetët: Shukrije Bytyçi, Shpjetim Bulliqi, Slavko Simić dhe Bojan Mitić (pa të drejtë vote).

Pjesëmarrës të ftuar: Abdullah Hoti- Ministër i Financave, Agim Krasniqi – zv. Ministër i Financave.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj- Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s:

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

1.1. Shqyrtimi i pjesë tekstuale të Projektligjit nr.05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Kryetari – propozojë që të bëhen disa ndryshime teknike si në vijim:

“Në në titullin e Projektligjit, fjala “Projektligj”, zëvendësohet me fjalën “Ligj”

“Në nenin 14, paragrafi 6, në fund të tekstit, pas fjalës “për”, shtohet fjala “vitin”

“ Në nenin 15, paragrafi 5, në rreshtin e katërt, shkronjat “eë”, zëvendësohet me lidhëzen “së”. Si dhe në rreshtin e pestë të këtij paragrafi, fjala “tableta”, zëvendësohet me fjalën “tabelën”

“Nën nenin 20, paragrafi 3, hiqet njëra fjalë “të”

“Në nenin 27 bëhet neni 26.

“Në nenin paragrafin 5 të nenit 11, që ka të bëjë shumën për financimin e RTK-së, në rreshtin e dytë, fjalët “nëntë milion e gjashtëqindmijë (9.600.000)” Euro, zëvendësohen me fjalët “njëmbëdhjetë milion (11,000,000) Euro”.

Komisioni njëzëri përkrahu propozimet për ndryshimet dhe plotësimet teknike në pjesën tesktuale të projektligjit, sipas propozimeve të bërë nga kryetari si më lartë

Safete Hadërgjonaj – lidhur me nenin 18 kam bërë vërejtje edhe në mbledhjen e komisionit dhe mendojë që ky nen është i pazbatueshëm dhe jo për faktin se nuk mund të krijohet sistemi, por për problemet që do të përballen organizatat buxhetore që do të jenë shumë të mëdha, e sidomos komunat. Ne si komision e kemi pranuar një kërkesë edhe nga asociacioni i komunave ku të gjitha komunat kanë reaguar për të fshirë nenin 18. Planifikimi pesëshifror do të jetë problem edhe për ministrinë dhe do të bëhet i pazbatueshëm dhe ne po krijojmë probleme, ku pastaj do të marrim vërejtje nga institucionet relevante ndërkombëtare dhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian. Prandaj, rekomandojë që nenin 18 të fshihet.

Kryetari – ky nen është diskutuar gjatë dhe janë ngritur shqetësimet për vështërsitë në zbatimin e tij. Unë e kam kuptuar që ka të bëjë me krijimin e një sistemi për të mos lejuar shumë levizje brenda kategorive dhe nënkategorive, por kjo kërkon një planifikim të saktë. Kjo paraqet sfidë për institucionet se sa janë të gatshme për një planifikim të tillë.

Besa Gaxherri – edhe unë kam pranuar kërkesa nga asociacioni i komunave për këtë nen, por arsyetimet që i ka dhënë ministri, dhe duke pasur parasysh zotimin në luftimin e krimit dhe korrupsionit ky nen ka për qëllim të vënies nën kontroll të shpenzimeve.

Avdullah Hoti - aktualisht ekziston sistemi për mënyrën e rregullimit të shpenzimeve kapitale. Me këtë nen, ne kemi propozuar rregullimin e sistemit edhe për shpenzimet për mallra dhe shërbime. Prandaj, kemi propozuar në nivele pesëshifrore në mënyrë që të mund ti shohim dhe kontrollojmë shpenzimet.

Bali Muharremaj - mendojë se duhet të hiqet neni 18 prej projektligjit.

Shukri Buja - neni 18 krijon probleme për komunën dhe administratat komunale nuk i kemi të përgaditura për zbatimin e këtij neni dhe prandaj edhe kemi shqetësimet nga komunat. Me këtë nen vendoset shumë kontroll, ku kërkohet edhe nënshkrimi i ministrit dhe përkundër qëllimit të mirë, komunat nuk janë të përgaditura për zbatimin e tij.

Labinotë Demi-Murtezi - pyeti ministrin, a është kjo mënyra e vetme me e përcjell menaxhimin e financave publike, në nivelin lokal?

Avdullah Hoti – ju si Kuvend me raportet periodike dhe vjetor financiare, nuk e dini se si po shpenzohen në detale shpenzimet për mallra dhe shërbime, përveç atyre kapitale. Prandaj është propozuar ky nen, që të kemi kontroll më të madh të shpenzimeve. Përkundër burokracisë që mund të krijohet, ne duhet të lëvizim në drejtim të kontrollit më të madh të shpenzimeve.

Shukri Buja – kontrolli i shpenzimeve bëhet nga asambltetë komunale dhe përmes thesarit. Kjo që është propozuar është e mirëseardhur, por komunat aktualisht nuk janë të përgaditura për zbatim.

Pas votimit, Kryetari konstatoi se propozimi për heqjen e nenit 18 të projektligjit nuk përkrahet dhe mbetet teksti si në projektligj.

Shukri Buja – propozojë që neni 24 të fshihet. 38 milion euro janë të planifikuar për veteranët. Nuk duhet të bëjmë kufizime siç është bërë me këtë nen. Ne nuk kemi nevojë me prejardhje deri me rishikim të buxhetit dhe të vëmë kufizime. Veteranët nuk do të rriten. Komisioni përkatës ka bërë certifikimin, ndërsa shkallën e validitetit do ta përcaktojë shkallën e invaliditetit.

Avdullah Hoti – jemi në program me FMN-në deri në maj të vitit 2017. Ky nen është pjesë e marrëveshjes me FMN-në dhe nëse e heqim këtë nen ne e prishim këtë marrëveshje.

Pas votimit, Kryetari konstatoi se me një votë Për, tetë vota Kundër, dhe asnjë Abstenim propozimi për heqjen e nenit 24 të projektligjit nuk përkrahet dhe mbetet teksti si në projektligj.

2.2. *Shqyrtimi i kërkesave dhe amendamenteve të propozuara nga Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport dhe deputetët/grupet parlamentare në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017*

Shqipe Pantina - sa i përket amendamentit të propozuar nga deputetja Aida Dërguti, ka të bëjë me heqjen e subvencioneve dhe transfereve nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, që ka qenë edhe vendim i Komisionit kur e kemi shqyrtuar qarkoren e dytë buxhetore, dhe unë mendojë që këto mjete duhet të shkojnë në Ministrinë e Shëndetësisë, sepse është e pakuptimtë që Kuvendi me pas subvencione dhe transfere për projekte që duhet me i realizue Qeveria.

Kryetari – arsyeja që duhet Kuvendi me pas shpenzime për subvencione dhe transfere lidhet me nevojat si me rastin e shpenzimeve për shenjtërimin e Nënës Terezë, organizimi i Asamblesë së NATO-së në Kosovë dhe rasti i shërimit të deputetit Bardhyl Meta.

Shukrije Bytyqi - kërkojë që të tragoni vullnet që të përkrahin kërkesën për ndarjen e 50,000 euro për Kompleksin e varrezave të dëshmorëve të Brigadës 121 të UÇK, “Ismet Jashari-Kumanova”, në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, sepse luftetarët e lirisë kanë dhënë shumë për Kosovën.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratojë propozimin që në organizatën buxhetore “Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale e Kosovës” me kod 27900, në tabelën 3.2, në kategorinë “shpenzime kapitale”, shtohet projekti i ri “Kompleksi i varrezave të dëshmorëve të brigadës 121 të UÇK-se Ismet Jashari-Kumanova – Kleçkë, Lipjan”, në shumë prej 30,000 euro.

Shukrije Bytyqi – kërkojë që të shikohet mundësia e përkrahjes së projektit për ndërtimin e tranzitit në Malishevë, pasi që është shumë e rëndësishme për këtë komunë.

Kryetari – propozojë që të përkrahet kërkesa për ndarjen e 20,000 euro për projektin për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sheshit “Adem Jashari”, në Komunën e Malishevës dhe mjetet të shkojnë në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale e Kosovës.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratojë propozimin që në organizatën buxhetore “Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale e Kosovës” me kod 27900, në tabelën 3.2, në kategorinë “shpenzime kapitale”, shtohet projekti i ri “Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit Adem Jashari” - Malishevë, në shumë prej 20,000 euro.

Bali Muharremaj - sa i përket projektit të ndërtimit të Shkollës Fillore “Vaso Pash Shkodrani” në Fshatin Leshan të Komunës së Suharekës, ky projekt është planifikuar buxhetin e vitit 2015. Për vitin 2016 kanë qenë të ndara 300,000 euro dhe për vitin 2017 janë planifikuar 150,000 euro. Kjo shkollë është në gjendje të vështirë. Kërkojë që të ndahen mjete në faza për realizimin e këtij projekti.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratojë propozimin që në organizatën buxhetore “Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë”, me kod organizativ 208, në nënprogramin – “Investimet kapitale në arsimin parauniversitar” me kod 98100, në tabelën 3.2, në kategorinë “shpenzime kapitale”, të

shtohet projekti i ri “Ndërtimi i shkollës fillore Vaso Pashë Shkodrani në fshatin Leshan të komunës së Suharekës“, ne shume prej 200,000 euro ne vitin 2017 dhe 200,000 euro ne vitin 2018.

Kryetari – propozojë që projekti “Ndërtimi i rrugës nacionale Deçan-Kufiri me Malin e Zi (Plavë), shuma prej 50,000 euro, të ndryshohet në shumën prej 300,000 euro.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratojë propozimin që në organizatën buxhetore “Ministria e Infrastrukturës”, me kod organizativ 205, nënprogrami – “Ndërtimet e reja të rrugëve” me kod 421”, në tabelën 3.2, në kategorinë “shpenzime kapitale”, projekti me kod 14111 “Ndërtimi i rrugës nacionale Deçan – kufiri me Malin e Zi”, shuma nga 50,000 euro, të ndryshohet në shumën 300,000 euro.

Shpejtim Bulliqi – lidhur me amendamentin e propozuar nga Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, ju njoftojë se Fakulteti i Shencave Matematiko Natyrore është i vetmi objekt në Universitetin e Prishtinës që nuk ka objekt të vetin. Ky projekt ka qenë edhe në buxhetin 2016 dhe janë ndarë vetëm 200,000 euro dhe 200,000 euro janë të ndarë edhe për vitin 2017. Në mungesë të objektit studentët në këtë fakultet e mbajnë mësimin edhe nëpër koridore, pasi që nuk ka salla të mjaftueshme. Prandaj, një sasi më e madhe e buxhetit të ndahet në vitin 2017, dhe në vitin tjetër pasues të përfundojë ky projekt.

Avdullah Hoti – për projekt janë ndarë 200,000 euro, varësisht prej dinamikës së projektit, ne në rishikim i ndajmë mjetet e nevojshme.

Sali Morina – shuma prej 200,000 euro është e pamjaftueshme për realizimin e projektit në fjalë. Por duke ditur edhe kohëzgjatjen e procedurave të prokurimit, dhe duke marrë parasysh zotimin e ministrisë, në këtë fazë të shkohet me këtë shumë, ndërsa në rishikim të ndahen mjete shtesë që të vazhdohet me realizimin e projekti.

Shqipe Pantina - unë mendojë që edhe proceduralisht me vetëm 200,000 euro nuk mund të realizohet projekti, pasi që nuk mund të hapet as tenderi. Unë e përkrahu amendamentin e komisionit.

Shpejtim Bulliqi – kërkojë që në këtë fazë të ndahen të paktën 500,000 euro për vitin 2017, pastaj të ndahen mjetet e nevojshme në fazat tjera për realizimin e projektit.

Shukrije Bytyqi – theksoi se e ndajë të njëjtin mendim me profesorin Bulliqi. FSHMN është në gjendje të mjerueshme, e sidomos Departamenti i Biologjisë ku kushtet për punën janë të vështira. Prandaj është e nevojshme të përkrahet ky projekt.

Kryetari – theksoi se ministria po sqaron se kontrata mund të lidhet për vlerën e planifikuar të projektit, ndërsa mjetet ndahen në fazët e caktuar të realizimit të këtij projekti në fjalë.

Bali Muharremaj – lidhur me projektin “Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi, në Suharekë, që është hera tretë që kërkojë këtë projekt. Kemi të bëjmë me një projekt që është në gjendje shumë të keqe. Po ashtu kërkojë që edhe për realizimin e projektit “Memoriali i viktimave civile të datës 26 Mars 1999 të Familjes Berisha, të ndahen mjete buxhetore.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratojë propozimin që në organizatën buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, nënprogrami – “Përkrahja institucionale për kulturë” me kod 80300, në tabelën 3.2, në kategorinë “shpenzime kapitale”, shtohet projekti i ri “Ndërtimi i shtëpisë së Kulturës Ukë Bytyqi në Suharekë” në shumë prej 150,000 euro ne vitin 2017, 300,000 euro ne 2018 dhe 500,000 euro ne vitin 2019.

Kryetari – theksoi kemi një kërkesë që të ndahen mjete buxhetore për realizimin e projektit për projekti “Ujësjiellësi per 10 fshatra dhe kyçja në burimet e reja”, në Komunën e Deçanit.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratojë propozimin që në organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210 - nënprogrami – “Burimet ujore” me kod 60300, në tabelën 3.2, në kategorinë “shpenzime kapitale”, të shtohet projekti “Ujësjiellësi per 10 fshatra dhe kyçja në burimet e reja”, në shumë prej 50,000 euro.

Fikrim Damka - Grupi Parlamentar 6+ ka kërkuar që të sigurohen mjete financiare për Objektivin e Qendrës Kulturore Turke në Prishtinë në shumë prej 150,000 euro. Në Mitrovicë i njëjti projekt është përfunduar dhe tash iniciative është që të ndërtohet edhe në Prishtinë.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratojë propozimin që në organizatën buxhetore “Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”, me kod organizativ 207, nënprogrami – “Përkrahja institucionale për kulturë” me kod 80300, në tabelën 3.2, në kategorinë “shpenzime kapitale”, të shtohet projekti i ri “Ndërtimi i Qendrës Kulturore Turke në Prishtinë” në shumë prej 75,000 euro.

Kryetari – kemi një kërkesë të Komunës së Leposaviqit dhe të Shterpcës.

Slavko Simić – projektet janë shumë të rëndësishme që të përkrahen për komunat në fjalë.

Agim Krasniqi – komunave buxhetin nuk mund t’iu ndërrohen nga ajo që është miratuar nga asamblëta komunale. Nëse ka projekt që mundet të realizohet përmes ministrive, ne jemi të gatshëm të realizohen.

Besa Gaxherri – me rastin e shqyrtimit dhe miratimit të Buxhetit 2016, për projektin “Kanalizimi ne Raushiq, Pejë”, në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kemi ndarë 100,000 euro dhe në procesverbal të komisionit, kemi konkluduar që për vitin 2017, të ndahen edhe 100,000 euro.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratojë propozimin që në organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, nënprogrami – “Burimet ujore” me kod 60300, në tabelën 3.2, në kategorinë “shpenzime kapitale”, të shtohet projekti me kod 14796 “Kanalizimi ne Raushiq, Pejë”, në shumë prej 100,000 euro.

Kretari – sa i përket kërkesave të Kuvendit, për auditimin e subjekteve politike, ne kemi rritur buxhetin nga 60,000 euro në 120,000 euro, që është edhe kërkesë e Zyrës së BE-së me rrit buxhetin për këtë qëllim. Ndërsa kërkojë nga sekretari i Kuvendit që të prezantojë kërkesat e Kuvendit.

Ismet Krasniqi – kërkesat e Kuvendit janë paraqitur me kohë në komision. Kërkesat shtesë tek programi i administratës, janë 16 pozita me një kosto prej 126,000 euro. Tek i njëjti program janë obligimet e kontraktuara për 2017 janë 10,800 euro. Janë të parapara 15,000 euro për 15 praktikantë. Janë paraparë 100,000 euro për samitin e kryetarëve të komisioneve parlamentare të Këshillit të Evropës, që organizon Komisioni për Punë të Jashtme. Kërkesat totale shtesë janë 271,000 euro. Një situatë jo e lakmueshme, pasi që në këtë komision është dashur që kërkesat e Kuvendit ti prezantojë një anëtarë i Kryesisë sipas Rregullores së Kuvendit. Kjo edhe për faktin se si administratë asnjëherë nuk po trajtohem në nivelin e kërkesave që po adresojmë.

Kryetari – mjetet që kanë tepruar nga buxheti i komisioneve të shpërndahen për deputetë.

Kryetari – propozojë që të përkrahet kërkesa e deputetit Danush Admei për projektin e ri “Ujësjiellësi ne Gadime, Lipjan”, në shumë prej 20,000 euro.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratojë propozimin që në organizatën buxhetore “Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor”, me kod organizativ 210, nënprogrami – “Burimet ujore” me kod 60300, në tabelën 3.2, në kategorinë “shpenzime kapitale”, shtohet projekti i ri “Ujesjellesi ne Gadime, Lipjan”, në shumë prej 20,000 euro.

2.3. Shqyrtimi i propozimeve të Ministrisë së Financave në Projektligjin nr.05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

Kryetari – thekojë se Ministria e Financave ka bërë disa propozime për amendamentimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, të cilat janë të gatshme dhe propozojë që të miratohen dhe të bëhen amendamente të komisionit.

Kryetari konstatoi se komisioni me tetë vota Për, një Kundër dhe asnjë Abstenim, miratoi propozimet e Ministrisë së Financave për amendamentimin e Projektligjit nr.05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë

Rekomandim

- I. Miratohet Raporti me amendamente në Projektligjin nr.05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017.
- II. Raporti me amendamentet procedohet për shqyrtim dhe miratim në komisionet tjera të përhershme dhe në Seancë plenare.

Mbledhja përfundoi në ora 20:42

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani